

IVA VASO

# DERMOKOZMETOLOGJIA

MANUAL  
I KOZMETOLOGJISË  
PËR PROFESIONISTËT  
E SË ARDHMES

DERMOKOZMETOLOGJIA  
IVA VASO



"Dermokozmetologjia" – Manual i Kozmetologjisë për Dermokozmetikën e Aplikuar", me autore Iva Vaso, është një vepër e gjerë akademike dhe profesionale, e konceptuar për të ndërtuar një kuptim të plotë të lëkurës, produkteve kozmetike dhe praktikave bashkëkohore dermo-estetike. Manuali ndërthur njohuritë shkencore me përvojën praktike, duke e trajtuar dermokozmetologjinë jo vetëm si një disiplinë që lidhet me bukurinë, por si një fushë ku estetika, shëndeti i lëkurës, siguria dhe etika profesionale janë të pandashme.

Përmbajtja është organizuar në gjashtë pjesë dhe nis me bazat anatomike, fiziologjike, mikrobiologjike dhe biokimike të lëkurës dhe anekseve të saj. Në vijim analizohen format e produkteve kozmetike, lëndët funksionale, eksipientët, aditivët, vitaminat, mineralet, antioksidantët, përbërësit biomimetikë, filtrat mbrojtës ndaj rrezatimit UV, si edhe substancat irrituese dhe alergene. Kjo strukturë i mundëson lexuesit të kuptojë jo vetëm se cilat produkte përdoren, por edhe mënyrën se si formulohen, mekanizmin e veprimit dhe kriteret mbi të cilat duhet të mbështetet përzgjedhja e tyre.

Një pjesë e rëndësishme e manualit i kushtohet dermokozmetikës së aplikuar: vlerësimi profesional të lëkurës, pastrimi të thellë, eksfolimi, peeling-ut kimik, mikrodermoabrazioni, hidrodermoabrazioni dhe ndërtimi të protokolleve të personalizuara. Trajtohen në mënyrë të detajuar tipologjitë dhe problematikat kryesore të lëkurës, duke përfshirë lëkurën e thatë, të yndyrshme, të kombinuar, akneike, të ndjeshme dhe mature, si edhe dermatitin atopik, dermatitin seborrheik, kuperozën, rosacea-n dhe proceset e plakjes intrinsike e ekstrinsike. Manuali përfshin gjithashtu veçoritë e lëkurës mashkullore, lëkurës së errët dhe asaj femënore.

Vëmendje e veçantë u kushtohet metodave moderne të biorigjenerimit dhe biostimulimit, mezoterapisë, polinukleotideve, PDRN-së, ekzosomeve, terapive autologe rigjeneruese dhe kombinimit të mikroshpimeve me radiofrekuencën. Përmbajtja zgjerohet më tej me problematikat estetike të zonës periokulare, bazat anatomike dhe teknike të përdorimit të fillerave dermalë dhe neuromodulatorëve, metodat e injektimit, dallimet ndërmjet materialeve dhe parimet e menaxhimit të komplikacioneve.

Në manual trajtohen edhe problematikat estetike të trupit, sistemi hemo-limfatik, edemat, celuliti, strijat, teknologjitë profesionale dhe masazhi. Kapituj të veçantë i kushtohen eliminimit të qimeve dhe teknologjive lazer, trikologjisë, kujdesit estetik të duarve, këmbëve dhe thonjve, si dhe produkteve kozmetike dekorative. Bazat e kimisë së përgjithshme, organike, inorganike dhe biokimisë plotësojnë formimin shkencor të lexuesit, ndërsa pjesa mbi legjislacionin, emërtesën INCI dhe sigurinë e produkteve kozmetike vendos praktikën profesionale brenda kuadrit të përgjegjësisë ligjore dhe etike.

Më shumë se një përmbledhje teknikash dhe protokollesh, “Dermokozmetologjia” synon të kultivojë një mënyrë profesionale të të menduarit: të vlerësohet përpara se të trajtohet, të kuptohet mekanizmi përpara se të zgjidhet procedura dhe të respektohet individualiteti përpara çdo ndërhyrjeje estetike. Sepse rezultati profesional nuk mbështetet vetëm te teknika, por te diagnoza e saktë, dija shkencore, siguria dhe aftësia për të ndërtuar trajtime të personalizuar.

Manuali është konceptuar si literaturë bazë për programet e studimit dhe formimit profesional të Skin’Or Academy, si dhe si një burim i vlefshëm konsultimi për kozmetologë, farmacistë, profesionistë të dermo-estetikës dhe të estetikës mjekësore. Ai u drejtohet të gjithë atyre që dëshirojnë të shkojnë përtej pyetjes “çfarë duhet të përdor?” dhe të kuptojnë në mënyrë të argumentuar shkencore “pse, kur dhe si duhet përdorur?”.

Iva Vaso





Dr. Iva Vaso është farmacistë dhe mjekë estetiste, me mbi dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën e dermo-estetikës, mjekësisë estetike dhe edukimit profesional.

Formimi i saj akademik ndërdisiplinor përfshin studimet në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, diplomë në Farmaci dhe në Estetikë–Nutricion, si dhe Masterin Profesional në Mjekësi Estetike, të përfunduar me certifikim ndërkombëtar CPD. Në vijim të angazhimit të saj në formimin mjekësor, aktualisht ndjek vitin e katërt të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë.

Ajo është themeluese dhe drejtuese e Skin'Or Medical Aesthetic Clinic dhe Skin'Or Academy në Tiranë. Veprimtaria e saj profesionale shtrihet në dy drejtime të ndërlidhura - praktikën klinike dhe edukimin profesional. Në praktikën klinike, ajo mbështetet në vlerësimin individual të pacientit, hartimin e protokolleve të personalizuar dhe përzgjedhjen e trajtimeve në përputhje me evidencën shkencore. Në fushën akademike dhe profesionale, angazhohet në mësimdhënie, trajnim dhe supervizim, me synim forcimin e kompetencave praktike dhe respektimin e standardeve të sigurisë, etikës dhe përgjegjësisë profesionale.

Si lektore dhe trajnuese, Dr. Iva Vaso ka kontribuar në formimin e profesionistëve të rinj dhe në zhvillimin e një qasjeje më të strukturuar, të informuar shkencërisht dhe etikisht të përgjegjshme ndaj praktikës estetike.

“Dermokozmetologjia” është rezultat i këtij rrugëtimi akademik, klinik dhe didaktik. E konceptuar si një manual bazë për studimin dhe formimin profesional në këtë fushë, ky manual trajton parimet shkencore, kriteret e vlerësimit dhe zbatimin praktik të njohurive dermokozmetologjike. Ajo u drejtohet kozmetologëve, estetistëve, studentëve të shkencave mjekësore dhe profesionistëve të fushës duke synuar t'u shërbejë si një burim i qartë, i strukturuar dhe praktik për përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.

ISBN 978-9928-04-577-5



9 789928 045775 >

Çmimi 9500 Lekë